



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË


Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë



## MANUAL UDHËZUES

Për licencë AML për mirëmbajtjen e avionëve, Pjesa - 66

DHJETOR 2019

	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

## Hyrje

Ky dokument është pronë e:

### **Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë**

Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1  
Pranë Parkut të Delegacioneve  
Tiranë / Shqipëri  
Po Box 205


Ndalohet çdo riprodhim ose ndryshim i këtij materiali, pa pëlqim me shkrim.

Shpërndarja e paautorizuar e këtij manuali ose pjesëve të tij, jashtë shpërndarjes zyrtare, sipas përkufizimit të këtij dokumenti, do të cilësohet si shkelje e procedurave të AAC-së dhe do të trajtohet përkatësisht me punonjësin përgjegjës.

Ky individ mund t'i nënshtrohet procedimit ligjor nga institucionet përkatëse ligjore.

Për Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar

**Drejtor Ekzekutiv**

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

## PARATHËNIE

Ky manual udhëzues ka për qëllim të ndihmojë aplikantët për të kryer aplikimin për lëshimin fillestar, mbajtjen, ndryshimin ose rinovimin për vazhdueshmërinë e liçensës së inxhinierit sipas kërkesave të specifikuar në rregulloren përkatëse në fuqi.

Personeli i përfshirë në mirëmbajtjen e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve duhet të plotësojë disa kërkesa teknike që dëshmojnë aftësinë dhe mjetet për kryerjen e detyrimeve dhe privilegjeve përkatëse.

Manuali ofron informacione dhe udhëzime të përgjithshme vetëm për zbatueshmërinë e Aneksit III, Pjesa 66, për Licencat e Mirëmbajtjes së Avionëve të lëshuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar në bazë të Urdhërit të Ministrit Nr. 110, Datë 02.10.2012 “Për Miratimin e rregullore mbi vlefshmërinë ajrore të produkteve, pajisjeve aeronautike dhe pjesëve të avionëve, si dhe për miratimin e organizatave dhe personelit të përfshire në këto detyra”.

Sidoqoftë, në të gjitha rastet duhet t'i referohen gjithmonë rregullave të zbatimit dhe dokumentacionit rregullues, së bashku me mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë (AMC) dhe Materialit udhëzues (GM).


Në Urdhrin e Ministrit Nr. 110, Datë 02.10.2012 paraqiten kategori të liçensash për sistemet avionike dhe elektrike të avionë përveç atyre të grupit të avionëve komplekse, për të pasqyruar nivelin e njohurive dhe kompleksitetin e avionit. Nëntitujt janë futur gjithashtu në plan-programin e provimit të Modullit Themelor Pjesë-66.

Ky manual është hartuar duke pasur parasysh referencat ligjore :


Urdhër i Ministrit Nr. 110, Datë 02.10.2012 “Për Miratimin e rregullore mbi vlefshmërinë ajrore të produkteve, pajisjeve aeronautike dhe pjesëve të avionëve, si dhe për miratimin e organizatave dhe personelit të përfshire në këto detyra”;

Udhëzim i Ministrit Nr.3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar;


Manuali i Proçedurave të Sektorit të Mbikqyrjes së Vlefshmërisë Ajrore O3-1.MAN.01

 <p>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</p>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

QËLLIMISHT E LENE BOSH

 <p>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</p>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001


QËLLIMISHT E LENE BOSH

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

## **PËRKUFIZIME**

**Për qëllimin e këtij manuali, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:**


- (a) ‘avion’ nënkupton çdo makinë, që përfton qëndrimin në atmosferë nga kundërveprimi i ajrit, përveç kundërveprimit të ajrit kundrejt sipërfaqes së tokës;
- (b) ‘staf çertifikues’ nënkupton personelin përgjegjës për lejimin në shërbim të një avioni ose një komponenti pas mirëmbajtjes;
- (c) ‘komponent’ nënkupton çdo motor, helikë, pjesë ose pajisje;
- (d) ‘Vazhdueshmëri e Vlefshmërisë Ajrore’ nënkupton të gjitha proceset që sigurojnë se, në çdo kohë në jetën e tij operuese, avioni është në përputhje me kërkesat e vlefshmërisë ajrore në fuqi dhe është në gjendje për operim të sigurt;
- (e) ‘detyrat kritike të mirëmbajtjes’ nënkupton një detyrë mirëmbajtjeje që përfshin assemblimin/formimin ose çdo çrregullim të një sistemi ose çdo pjesë të një avioni, motori ose helike që, nëse ndodh një gabim gjatë operimit të tij, mund të rrezikojë direkt sigurinë e fluturimit;

	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

**SHKURTIME**

**Në këtë manual do të përdoren shkurtime e mëposhtëme, të cilat do të nënkuptojnë:**


AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë
EASA	Agjencia Europiane e Sigurisë së Aviacionit
EC	Komisioni European
RSH	Republika e Shqipërisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
DE	Drejtor Ekzekutiv
DMSOVA	Drejtorja e Mbikqyrjes së Operatoreve Ajror dhe Organizatave të Mirëmbajtjes
O3-1	Spektori i Mbikqyrjes së Vlefshmërisë Ajrore
FMAN	Formulari i Manualit të sektorit të Mbikqyrjes së Vlefshmërisë Ajrore
FRM	Formular
TAB	Tabelë

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

## Tabela e Përmbajtjes

Hyrje.....	2
PARATHËNIE .....	3
LISTA E FAQEVE EKZISTUESE .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
LISTA E SHPËRNDARJES .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
REGJISTËR I RISHIKIMEVE.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
PËRKUFIZIME .....	6
Kapitulli 1- APLIKIMI FILLESTAR PËR NJË LIÇENSË TË MIRËMBAJTJES SË AVIONIT PJESA 66.....	9
Kapitulli 2- RINOVONI NJË LIÇENSË TË MIRËMBAJTJES SË AEROPLANIT PJESA 66 .....	12
Kapitulli 3- SHTONI NJË KATEGORI OSE NËN KATEGORI: EASA PJESA 66 LIÇENSË PËR MIRËMBAJTJEN E AVIONËVE .....	14
Kapitulli 4- SHTONI PRIVILEGJET E KATEGORISË C: EASA PJESA 66 LIÇENSË PËR MIRËMBAJTJEN E AVIONËVE.....	17
Kapitulli 5- SHTONI NJË VLERËSIM TIPI: EASA PJESA 66 LIÇENSË PËR MIRËMBAJTJEN E AVIONËVE.....	19
Shtojca I- Formular .....	21



 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

## Kapitulli 1

### APLIKIMI FILLESTAR PËR NJË LICENCË TË MIRËMBAJTJES SË AVIONIT PJESA 66

#### 1.1 - KUSHTET E NEVOJSHME:

Aplikantët për pajisjen me AML Pjesa 66, duhet të demonstrojnë nivelin e njohurive në modulet përkatëse të lëndëve me anë të provimit, në përputhje me Urdhrin e Ministrit Nr. 110, Datë 02.10.2012, Aneksi III, Shtojca I. Provimet do të bëhen nga një organizatë trajnimi e miratuar në përputhje me Shtojcën IV (Pjesa-147) ose nga Autoriteti i Aviacionit Civil.


Eksperiencia e nevojshme e përvojës praktike të mirëmbajtjes duhet të jetë përfituar në një organizatë të Mirëmbajtjes EASA Pjesa-145 ose një organizatë e pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil sipas standarteve në fuqi, dhe duhet të provohet me logbooks/worksheets të nënshkuara nga personi i ngarkuar.

Eksperiencia e kërkuar përkatësisht për kategorinë A, nënkategoritë B 1.2, B 1.4 dhe kategorinë B3 do të jetë:

- 3 vjet eksperiencë praktike në mirëmbajtje në avion operues, nëse aplikanti nuk ka trajnimin teknik përkatës të mëparshëm; ose
- 2 vjet eksperiencë praktike në mirëmbajtje në avion operues dhe përfundimin e trajnimit të konsideruar të përshtatshëm nga autoriteti kompetent si punonjës i kualifikuar, në një aktivitet teknik; ose
- 1 vit eksperiencë praktike në mirëmbajtje në avion operues dhe përfundimin e një kursi të trajnimit bazë të miratuar në përputhje me Aneksin IV (Pjesa-147);

Eksperiencia e kërkuar përkatësisht për kategorinë B2 dhe nënkategoritë B1.1 dhe B1.3 do të jetë:

- 5 vjet eksperiencë praktike në mirëmbajtje në avion operues, nëse aplikanti nuk ka trajnimin teknik përkatës të mëparshëm; ose
- 3 vjet eksperiencë praktike në mirëmbajtje në avion operues dhe përfundimin e trajnimit të konsideruar të përshtatshëm nga autoriteti kompetent si punonjës i kualifikuar, në një aktivitet teknik; ose
- 2 vjet eksperiencë praktike në mirëmbajtje në avion operues dhe përfundimin e një kursi të trajnimit bazë të miratuar në përputhje me Aneksin IV (Pjesa-147);

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

Kërkesa e mësipërme e përvojës nënkupton praktikë që përfshin fusha të ndryshme të aktiviteteve të mirëmbajtjes në aeroplanët operues specifik për kategorinë për të cilën duhet të aplikohen.

Kurset e trajnimit, ekzaminimet e njohurive bazë dhe përvoja relevante e mirëmbajtjes praktike duhet të jenë përmbytur dhe të kenë përfunduar brenda 10 viteve para aplikimit për një licencë të mirëmbajtjes së avionëve.

Letër rekomandimi duhet të plotësohet nga Menaxheri i Cilësisë ose një person i ngarkuar në Departamentin e Cilësisë së punëdhënësit aktual, ose organizatës ku fitohet përvoja.

#### 1.2 - Tarifa për Licencën e mirëmbajtjes.

Liçensa e Mirëmbajtjes kushton 25.000 lek. Një kopje e mandatit të pagesës duhet dorëzuar Autoritetin e Aviacionit Civil në momentin fillestar të aplikimit.

Detajet e plota janë në dispozicion në skemën aktuale të tarifave, (UDHËZIM Nr. 2225, date 13.5.2013 PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE NË AVIACIONIN CIVIL).


#### 1.3 - Vlefshmëria

Liçensa e Mirëmbajtjes së Avionëve Pjesa 66 është e vlefshme për 5 vjet nga data e lëshimit.

#### 1.4 - Informacione të tjera.

Për të siguruar plotësim të saktë të kërkesës, aplikantët duhet t'i referohen rregullave, rregulloreve dhe formularëve të mëposhtëm:

- A- Formë Aplikimi: O3-1.FMAN.01.FRM.019 - Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e liçensës së inxhinierit
- B- Letër rekomandim: O3-1.FMAN.01.FRM.019b
- C- Urdhër i Ministrit Nr. 110, Datë 02.10.2012 “Për Miratimin e rregullore mbi vlefshmërinë ajrore të produkteve, pajisjeve aeronautike dhe pjesëve të avionëve, si dhe për miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”;
- D- Skema e tarifave (UDHËZIM Nr. 2225, datë 13.5.2013 PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE NË AVIACIONIN CIVIL)

 <p>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</p>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

#### 1.5 - Elementët e aplikimit janë si më poshtë.


- A- Forma e Aplikimit: O3-1.FMAN.01.FRM.019- Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e licencës së inxhinierit.
- B- Kopje e pasaportës/kartës së identitetit të vlefshme.
- C- Kopje të noterizuara ose origjinale të Çertifikatave të Provimeve të kryera për kategorinë / nënkategorinë e aplikuar
- D- Kopje të noterizuara ose origjinale të Çertifikatave që vërtetojnë njohuritë bazë të fituara nga një Organizatë Pjesa 147 e aprovuar nga EASA.
- E- Kopje të noterizuara ose origjinale të logbooks/worksheets të punës që tregojnë provat e përvojës praktike të mirëmbajtjes së fituar.
- F- Kopje të noterizuara ose origjinale të dokumentave shtesë nëse kërkohen nga Autoritetit Kopetent.
- G- Letrën e Rekomandimit duke u siguruar që ajo është plotësuar nga Menaxheri i Cilësisë ose një person i ngarkuar në Departamentin e Cilësisë në mbështetje të aplikimit tuaj.

#### 1.6 – Mënyra e aplikimit.

Pasi të jenë përmbushur të gjitha kërkesat, plotësohet Forma e Aplikimit: O3-1.FMAN.01.FRM.019- Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e licencës së inxhinierit dhe dërgohet me postë pranë Autoriteti të Aviacionit Civil së bashku me dokumentat mbështetës.

#### 1.7 - Ecuria e procesit

- A- Vlerësimi i aplikimit kryhet nga një Inspektor ose Përgjegjës i Liçensimit në AAC.
- B- Pas një vlerësimi pozitiv, liçensa përpunohet, nënshkruhet dhe njoftohet aplikanti për t'u paraqitur personalisht për tërheqjen e saj.
- C- Autoriteti i Aviacionit Civil kontakton aplikantin nëse ka ndonjë pyetje në lidhje me aplikimin dhe mund ta mbajë kërkesën në pritje për 30 ditë pune deri në ardhjen e ndonjë dokumentacioni shtesë që duhet të dorëzohet.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

D- Nëse brenda 30 ditëve procesi nuk përfundon për shkak të mos paraqitjes së dokumentacionit të plotë, procesi do të rinisë sërish nga hapi fillestar dhe pagesa do të bëhet sërish.

## Kapitulli 2

### RINOVIMI I NJË LICENCE TË MIRËMBAJTJES SË AVIONIT Pjesa 66

#### 2.1 - KUSHTET E NEVOJSHME:

Aktualisht nuk ka ndonjë kërkesë të lidhur me përvojën në punë për të rinovuar licencën të mirëmbajtjes e avionit Pjesa 66.

Aplikimi për të rinovuar vlefshmërinë e licencës për mirëmbajtjen e avionit Pjesa 66, kryhet 30 ditë para datës së skadimit.

*Shënim: Nëse arsyeja e aplikimit është ndryshimi i emrit apo shtetësisë, aplikimi duhet të shoqërohet me evidencë shtesë, p.sh. akti i ndryshimit të emrit / certifikatës së martesës / pasaportës së vlefshme.*

#### 2.2 - Tarifa e aplikuar

Licensa e Mirëmbajtjes kushton 25.000 lek. Një kopje e mandatit të pagesës duhet dorëzuar në AAC në momentin fillestar të aplikimit.

Detajet e plota janë në dispozicion në skemën aktuale të tarifave, (UDHËZIM Nr. 2225, datë 13.5.2013 PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE NË AVIACIONIN CIVIL).


#### 2.3 - Vlefshmëria

Licensa e Mirëmbajtjes së Avionëve Pjesa 66 është e vlefshme për 5 vjet nga data e lëshimit.

#### 2.4 - Informacione të tjera.

Për të siguruar plotësim të saktë të aplikimit, aplikantët duhet të referohen rregullave, rregulloreve dhe formularëve të mëposhtëm.

A- Formë Aplikimi: O3-1.FMAN.01.FRM.019 - Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e licencës së inxhinierit

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

B- Letër rekomandim: O3-1.FMAN.01.FRM.019b

C- Urdhër i Ministrit Nr. 110, Datë 02.10.2012 “Për Miratimin e rregullore mbi vlefshmërinë ajrore të Produkteve, pajisjeve aeronautike dhe pjesëve të avionëve, si dhe për miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”

D- Skema e tarifave (UDHËZIM Nr. 2225, date 13.5.2013 PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE NË AVIACIONIN CIVIL)

## 2.5 - Elementët e aplikimit

A- Forma e Aplikimit: O3-1.FMAN.01.FRM.019- Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e licensës së inxhinierit.

B- Për mbajtësit ekzistues të licencës, licenca origjinale e Mirëmbajtjes së Avionëve Pjesa 66 duhet të paraqitet me çdo kërkesë për ndryshim ose rinovim të licensës së inxhinierit.

C- Nëse arsyeja e aplikimit është për ndryshimi i emrit apo shtetësisë, aplikimi duhet të shoqërohet me evidenca shtesë, p.sh. akti i ndryshimit të emrit / certifikatës së martesës / pasaportës së vlefshme të noterizuara.

D- Në rast se aplikohet jashtë afateve të kërkuara, do të zbatohen parashikimet e pikës 66.A.40 të Urdhërit Nr.110 datë 02.10.2012.

*Shënim - AAC ka të drejtë të kërkojë kthimin/peçullimin/revokimin e Licensës së Mirëmbajtjes së Avionëve Pjesë 66 në çdo hap të aplikimit.*


## 2.6 - Aplikimi

Pasi të jenë përmbushur të gjitha kërkesat, duhet të plotësohet Forma e Aplikimit: O3-1.FMAN.01.FRM.019 Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e licencës së inxhinierit dhe të dërgohet me postë pranë Autoriteti të Aviacionit Civil së bashku me dokumenta mbështetës.

## 2.7 - Ecuria e procesit

A- Vlerësimi i aplikimit kryhet nga një Inspektor ose Përgjegjës i Licencimit.

B- Pas një vlerësimi pozitiv, licenca përpunohet, nënshkruhet dhe njoftohet aplikanti për tu paraqitur personalisht për tërheqjen e saj.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

- C- Autoriteti i Aviacionit Civil mund të kontaktojë aplikantin nëse ka ndonjë pyetje në lidhje me kërkesën dhe mund ta mbajë kërkesën në pritje për 30 ditë pune deri në ardhje të ndonjë dokumentacioni shtesë që duhet të dorëzohet.
- D- Nëse brenda 30 ditëve procesi nuk përfundon për shkak të mos paraqitjes së dokumentacionit të plotë, procesi do të rinis sërish nga hapi fillestar dhe pagesa do të bëhet sërish.

## Kapitulli 3

### SHTIMI I NJË KATEGORIE OSE NËN KATEGORIE: PJESA 66 SIPAS EASA-S, LICENCË PËR MIRËMBAJTJEN E AVIONËVE

#### 3.1 - KUSHTET E NEVOJSHME:

Aplikanti që aplikon për shtim kategorie duhet të kenë një licencë ekzistuese të Mirëmbajtjes së Avionëve Pjesa 66 dhe të ketë përmbushur kërkesat përkatëse të njohurive dhe përvojës për të përfshirë një kategori / nën-kategori tjetër.


*Përvoja e fituar nga një Organizatë Mirëmbajtje EASA Pjesa 145 ose një organizatë e pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, duhet të vërtetohet në formën e logbooks/worksheets të nënshkruara nga personi i ngarkuar*

Për shtim të kategorive apo të nënkategorive të licencës së mirëmbajtjes së avionit të Pjesës 66, kërkohet të plotësimi i njohurive me modulet përkatëse të aplikueshme për Kategorinë/Nën-Kategorinë për të cilën aplikohet.

Shënim: Për informacione mbi modulet/modulet e pjesëve, të nevojitura referim duhet të bëhet në listen në tabelën : Appendix 11-6 – O3-1.MAN.01.

Aplikanti duhet të plotësojë kërkesën minimale të përvojës për mirëmbajtjen e avionëve civil, të përshtatshme për kategorinë/nën-kategori shtesë të licencës, të aplikuar siç përcaktohet në UM nr 110/2012, Shtojca IV. Kjo përvojë mund të dokumentohet në formën e logbooks/worksheets duke siguruar që detyrat janë nënshkruar nga personi përgjegjës.

Letra e rekomandimit do të duhet të plotësohet nga Menaxheri i Cilësisë ose një person i autorizuar brenda Departamentit të Cilësisë së punëdhënësit aktual, ose organizatës ku fitohet përvoja.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

### 3.2 - Tarifa e zbatueshme

Liçensa e Mirëmbajtjes kushton 25.000 lek. Një kopje e mandatit të pagesës duhet dorëzuar në momentin fillestar të aplikimit.

Detajet e plota janë në dispozicion në skemën aktuale të tarifave, (UDHËZIM Nr. 2225, datë 13.5.2013 PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE NË AVIACIONIN CIVIL).


### 3.3 - Informacione të tjera

Për të siguruar plotësim të saktë të aplikimit, aplikantët duhet të referohen rregullave, rregulloreve dhe formularëve të mëposhtëm:

- A- Formë Aplikimi: O3-1.FMAN.01.FRM.019 - Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e liçensës së inxhinierit
- B- Letër rekomandim: O3-1.FMAN.01.FRM.019b
- C- Urdhër i Ministrit Nr. 110, Datë 02.10.2012 “Për Miratimin e rregullore mbi vlefshmërinë ajrore të Produkteve, pajisjeve aeronautike dhe pjesëve të avionëve, si dhe për miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”
- D- Pjesa 147 - Organizatat e trajnimit të miratuara
- E- Skema e tarifave (UDHËZIM Nr. 2225, datë 13.5.2013 PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE NË AVIACIONIN CIVIL)

### 3.4 - Elementët e aplikimit janë si më poshtë:

- A- Forma e Aplikimit: O3-1.FMAN.01.FRM.019 Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e liçensës së inxhinierit.
- B- Letrën e Rekomandimit duke u siguruar që ajo është plotësuar nga Menaxheri i Cilësisë ose një person i ngarkuar në Departamentin e Cilësisë në mbështetje të aplikimit .
- C- Kopje e pasaportës/kartës së identitetit tuaj të vlefshme.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

- D- Për mbajtësit ekzistues të licensës, licensa origjinale e Mirëmbajtjes së Avionëve të Pjesës 66 duhet të paraqitet me çdo kërkesë për ndryshim ose rinovim të licensës së një inxhinieri.
- E- Kopje të noterizuara ose origjinale të Çertifikatave të Provimeve të kryera për kategorinë / nënkategorinë e aplikuar
- F- Kopje të noterizuara ose origjinale të Çertifikatave që vërtetojnë njohuritë bazë të fituara nga një Organizatë Pjesa 147 e aprovuar nga EASA ose një organizatë e pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.
- G- Kopje të noterizuara ose origjinale të logbooks/worksheets të punës që tregojnë provat e përvojës praktike të mirëmbajtjes së fituar.

Shënim - AAC ka të drejtë të kërkojë kthimin e Lejes së Mirëmbajtjes së Avionëve Pjesë 66 në çdo pikë të aplikimit .


### 3.5- Aplikimi

Pasi të jenë përmbushur të gjitha kërkesat, plotësohet Forma e Aplikimit: O3-1.FMAN.01.FRM.019 Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e licensës së inxhinierit dhe dërgohet me postë pranë Autoriteti të Aviacionit Civil së bashku me dokumentat mbështetës.

### 3.6 - Ecuria e procesit

- A- Vlerësimi i aplikimit kryhet nga një Inspektor ose Përgjegjës i Licencimit.
- B- Pas një vlerësimi pozitiv, licensa përpunohet, nënshkruhet dhe njoftohet aplikanti për tu paraqitur personalisht për tërheqjen e saj.
- C- Autoriteti i Aviacionit Civil mund të kontaktojë aplikantin nëse ka ndonjë pyetje në lidhje me kërkesën dhe mund ta mbajë kërkesën në pritje për 30 ditë pune deri në ardhjen të ndonjë dokumentacioni shtesë që duhet të dorëzohet.
- D- Nëse brenda 30 ditëve procesi nuk përfundon për shkak të mos paraqitjes së dokumentacionit të plotë, procesi do të rinis sërish nga hapi fillestar dhe pagesa do të bëhet sërish.



	<b>Manual Udhëzues</b>	
	<b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

## Kapitulli 4

### SHTIMI I PRIVILEGJEVE TE KATEGORISË C: PJESA 66 SIPAS EASA-S, LICENCË PËR MIRËMBAJTJEN E AVIONËVE

#### 4.1 - KUSHTET E NEVOJSHME:

Aplikanti për shtim të privilegjeve të Kategorisë C, duhet të ketë një lloj licëse të mirëmbajtjes së avionit të vlerësuar me një lloj tipi dhe të ketë ushtruar privilegje të kategorisë B1 / B2 për 3 vjet ose më shumë.

Aplikanti duhet të ketë një autorizim të organizates së mirëmbajtjes, Pjesës 145 të aprovuar nga EASA ose një organizatë e pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për një lloj tipi të futur në licënsën e Pjesës 66, të mbajtur për një minimum prej 3 vjetësh.

Eksperienca e kërkuar sipas kategorive përkatësisht është si më poshtë:

Për kategorinë C në lidhje me avionët e mëdhenj:

- 3 vjet përvojë në ushtrimin e privilegjeve të kategorisë B1.1, B1.3 ose B2 në avionë të mëdhenj, ose
- Përvojë 5 vjeçare e ushtrimit të privilegjeve të kategorisë B1.2 ose B1.4 në avionë të mëdhenj.

Për kategorinë C në lidhje me avionët e tjerë veç atyre të mëdhenj:

3 vjet përvojë në ushtrimin e privilegjeve të kategorisë B1 ose B2 në avionët e tjerë veç atyre të mëdhenj.


Letra e rekomandimit do të duhet të plotësohet nga Menaxheri i Cilësisë ose një person i autorizuar brenda Departamentit të Cilësisë së punëdhënësit aktual, ose organizatës ku fitohet përvoja.

*Shënim: Nëse po aplikohet për ndryshimin e emrit dhe kombësisë, do të kërket të sigurohen prova në mbështetje të kërkesës, p.sh. akti i ndryshimit të emrit / certifikatës së martesës / pasaportës së vlefshme.*

#### 4.2 - Tarifa

Licënsa e Mirëmbajtjes kushton 25.000 lek. Një kopje e mandatit të pagesës duhet dorëzuar në momentin fillestar të aplikimit.

Detajet e plota janë në dispozicion në skemën aktuale të tarifave, (UDHËZIM Nr. 2225, datë 13.5.2013 PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE NË AVIACIONIN CIVIL).

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

#### 4.3- Elementët e aplikimit janë si më poshtë:

- A- Forma e Aplikimit: O3-1.FMAN.01.FRM.019 Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e licencës së inxhinierit.
- B- Kopje e pasaportës/kartës së identitetit të vlefshme.
- C- Për mbajtësit ekzistues të liçensës, liçensa origjinale e Mirëmbajtjes së Avionëve të Pjesës 66 duhet të paraqitet me çdo kërkesë për ndryshim ose rinovim të liçensës së inxhinierit.
- D- Autorizimi i organizatës së mirëmbajtjes së Pjesës 145 të aprovuar nga EASA ose një organizatë e pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, plotësuar nga Menaxheri i Cilësisë për ushtrimin e privilegjeve në një periudhë jo më pak se 3-vjet si B1/B2.
- E- Letrën e Rekomandimit duke u siguruar që ajo është plotësuar nga Menaxheri i Cilësisë ose një person i ngarkuar në Departamentin e Cilësisë në mbështetje të aplikimit.


Shënim - AAC ka të drejtë të kërkojë kthimin e Lejes së Mirëmbajtjes së Avionëve Pjesë 66 në çdo pikë të aplikimit.

#### 4.4 - Aplikimi

Pasi të jenë përmbushur të gjitha kërkesat, plotësohet Forma e Aplikimit: O3-1.FMAN.01.FRM.019 Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e licencës së inxhinierit dhe dërgojeni atë me postë pranë Autoriteti të Aviacionit Civil së bashku me dokumentat mbështetës.

#### 4.5 - Ecuria e procesit

- A- Vlerësimi i aplikimit kryhet nga një Inspektor ose Përgjegjës i Liçensimit.
- B- Pas një vlerësimi pozitiv, liçensa përpunohet, nënshkruhet dhe njoftohet aplikanti për tu paraqitur personalisht për tërheqjen e saj.
- C- Autoriteti i Aviacionit Civil mund të kontaktojë aplikantin nëse ka ndonjë pyetje në lidhje me kërkesën dhe mund ta mbajë kërkesën në pritje për 30 ditë pune deri në ardhjen të ndonjë dokumentacioni shtesë që duhet të dorëzohet.
- D- Nëse brenda 30 ditëve procesi nuk përfundon për shkak të mos paraqitjes së dokumentacionit të plotë, procesi do të rinis sërish nga hapi fillestar dhe pagesa do të bëhet sërish.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

## Kapitulli 5

### SHTIMI I NJË VLERËSIMI TIPI: LICENCË PËR MIRËMBAJTJEN E AVIONËVE PJESA 66

*Licënsa jep të drejtë të ushtrohen privilegje certifikimi në një tip specifik të avionit*

#### 5.1 - KUSHTET E NEVOJSHME PËR KËTË APLIKIM JANË:

Aplikanti dduhet të ketë një licensë ekzistuese të Mirëmbajtjes Pjesa 66 dhe të ketë përmbushur kërkesat e plota sipas UM nr 110/2012, Shtojcën III, Pjesa 66, 66.A.45.

Trajnimi përkatës teorik për vlerësimin e llojit duhet te jete kryer në një organizatë të aprovuar të trajnimit siaps Pjesës 147.

Trajnimi përkatës për vlerësimin e llojit praktik është kryer në një organizatë të aprovuar të Pjesës 147 ose një organizatë të aprovuar sipas Pjesës 145.

Megjithatë nëse aplikohet që kategorizimi i tipit të parë të miratohet në licensën për mirëmbajtjen e të avionëve sipas pjesës 66, atëherë duhet që OJT e aprovuar të jetë kryer në një organizatë të aprovuar sipas Pjesës 145 në mbështetje të Çertifikatave teorike dhe praktike të njohjes.

Aktualisht për shtimin e kategorizimit të tipit mund të pranohen Çertifikatat e Njohjes të lëshuara nga organizata të miratuara sipas Pjesës 147.


#### 5.2 - Tarifa e zbatueshme

Licënsa e Mirëmbajtjes kushton 25.000 lek. Një kopje e mandatit të pagesës duhet dorëzuar në momentin fillestar të aplikimit.

Detajet e plota janë në dispozicion në skemën aktuale të tarifave, (UDHËZIM Nr. 2225, datë 13.5.2013 PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE NË AVIACIONIN CIVIL).

#### 5.3 - Elementët e aplikimit

A- Forma e Aplikimit: O3-1.FMAN.01.FRM.019 Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e licencës së inxhinierit.

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

- B- Kopje e pasaportës/kartës së identitetit tuaj të vlefshme.
- C- Për mbajtësit ekzistues të licencës, liçensa origjinale e Mirëmbajtjes së Avionëve të Pjesës 66 duhet të paraqitet me çdo kërkesë për ndryshim ose rinovim të licencës së një inxhinieri.
- D- Kopje të noterizuara të lëshuara nga Pjesa 147 të Çertifikatës së Njohjes (e zbatueshme për llojin (et) për të cilat aplikohet) që mbulojnë elementët teorikë dhe praktikë të çertifikuar nga Menaxheri i Cilësisë.
- E- Nëse ky është kategorizimi i tipit të parë që kërkohet, brenda çdo kategorie të caktuar të licencës ose nën-kategorisë (B1.1, B1.3, B2 etj.). Atëherë OJT e aprovuar duhet të dorëzohet e firmosur nga menaxheri i cilësisë.
- F- Kopje të noterizuara të çertifikuara të logbooks/worksheets që tregojnë prova të përvojës praktike të mirëmbajtjes së fituar.
- G- Letrën e Rekomandimit duke u siguruar që ajo është plotësuar nga Menaxheri i Cilësisë ose një person i ngarkuar në Departamentin e Cilësisë në mbështetje të aplikimit.


Shënim - AAC ka të drejtë të kërkojë kthimin e licencës fillestare të Pjesës 66 të Mirëmbajtjes së Avionëve në çdo pikë të aplikimit tuaj.

#### 5.4 - Aplikimi

Pasi të jenë përmbushur të gjitha kërkesat plotësohet Forma e Aplikimit: O3-1.FMAN.01.FRM.019 Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e liçensës së inxhinierit dhe dërgohet me postë pranë Autoriteti të Aviacionit Civil së bashku me dokumentat mbështetës.

#### 5.5 -Ecuria e procesit




- A- Vlerësimi i aplikimit plotësohet nga një Inspektor ose Përgjegjës i Liçensimit.
- B- Pas një vlerësimi pozitiv, liçensa përpunohet, nënshkruhet dhe njoftohet aplikanti për tu paraqitur personalisht për tërheqjen e saj.
- C- Autoriteti i Aviacionit Civil mund të kontaktojë aplikantin nëse ka ndonjë pyetje në lidhje me kërkesën dhe mund ta mbajë kërkesën në pritje për 30 ditë pune deri në ardhje të ndonjë dokumentacioni shtesë që duhet të dorëzohet.


 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

D- Nëse brenda 30 ditëve procesi nuk përfundon për shkak të mos paraqitjes së dokumentacionit të plotë, Procesi do të rinisi sërish nga hapi fillestar dhe pagesa do të bëhet sërish.

## Shtojca I

### Formular

Forma e Aplikimit: O3-1.FMAN.01.FRM.019	 FRM.019.doc
Tabela e moduleve: Appendix 11-6 – O3-1.MAN.01	 TAB.066.docx
Letra e Rekomandimit : O3-1.FMAN.01.FRM.019b	 FRM.019b.docx

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

Formën e Aplikimit: O3-1.FMAN.01.FRM.019 Aplikimi për lëshimin fillestar, ndryshimin ose rinovimin e licencës së inxhinierit.

### Application Form – ACAA-AML/App-19

I wish to apply for initial/amendment/renewal of Part-66 compliant AML as indicated and confirm that the information contained in this form was correct at the time of application.

I herewith confirm that:

1. I am not holding any Part-66 AML issued in another Member State or any AML from another state,
2. I have not applied for any Part-66 AML in another Member State or any AML from another state and,
3. I never had a Part-66 AML issued in another Member State, or any AML from another state which was revoked or suspended in any other Member State or other state.

I also understand that any incorrect information could disqualify me from holding a Part-66 compliant AML.

Signed: \_\_\_\_\_ Name: \_\_\_\_\_

Date: \_\_\_\_\_

I wish to claim the following credits (if applicable):

\_\_\_\_\_

Experience credit for Part-147 training:

Examination credit for equivalent exam certificates \_\_\_\_\_

Please enclose all relevant certificates

**Recommendation (if applicable):** It is hereby certified that the applicant has met the relevant maintenance knowledge and experience requirements of Part-66 of MO No 110/ 2012 and it is recommended that the competent authority grants or endorses the Part- 66 compliant AML.

Signed: \_\_\_\_\_ Name: \_\_\_\_\_

Position: \_\_\_\_\_ Date: \_\_\_\_\_



**Manual Udhëzues**  
**AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve**

Zotëruesi

O3

Dokumenti

O3-1.MU/PT.001

Application for Initial/amendment/renewal of Part-66 compliant AML | ACAA-AML/App-19

**APPLICANT DETAILS:**

Name: \_\_\_\_\_

Address: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Nationality: \_\_\_\_\_ Date and Place of Birth: \_\_\_\_\_

**Part-66 AML Details (If applicable)**

License No: \_\_\_\_\_ Date of Issue: \_\_\_\_\_

**EMPLOYER DETAILS:**

Name: \_\_\_\_\_

Address: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Maintenance Organization Approval Reference: \_\_\_\_\_

Tel: \_\_\_\_\_ Fax: \_\_\_\_\_

**APPLICATION FOR: (Tick relevant boxes)**

Initial AML  Amendment of AML  Renewal of AML

**Rating**

	<b>A</b>	<b>B1</b>	<b>B2</b>	<b>B3</b>	<b>C</b>
Aeroplane Turbine	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>			
Aeroplane Piston	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>			
Helicopter Turbine	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>			
Helicopter Piston	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>			
Avionics			<input type="checkbox"/>		
Piston engine non-pressurized aeroplanes of MTOM of 2t and below				<input type="checkbox"/>	
Large Aircraft					<input type="checkbox"/>
Aircraft other than large aircraft					<input type="checkbox"/>

Type endorsement/Rating endorsement/ Limitation removal (if applicable):  
\_\_\_\_\_



 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

Tabela e moduleve: Appendix 11-6 – O3-1.MAN.01.

Qualification on basic subjects for AML Categories/subcategories						
Subject module	A or B1 Aeroplane with:		A or B1 helicopter with:		B2	B3
	Turbine engine(s)	Piston engine(s)	Turbine engine(s)	Piston engine(s)	Avionics	Piston-engine non-pressurized aeroplanes 2000 kg MTOM and below
1	x	x	x	x	x	x
2	x	x	x	x	x	x
3	x	x	x	x	x	x
4	x	x	x	x	x	x
5	x	x	x	x	x	x
6	x	x	x	x	x	x
7A	x	x	x	x	x	
7B						x
8	x	x	x	x	x	x
9A	x	x	x	x	x	
9B						x
10	x	x	x	x	x	x
11A	x					
11B		x				
11C						x
12			x	x		
13					x	
14					x	
15	x		x			
16		x		x		x
17A	x	x				
17B						x

x\*- përmbajtje e pjesëshme e pikave të modulit



 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues</b> <b>AML Pjesa - 66 licencë për mirëmbajtjen e avionëve</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	O3-1.MU/PT.001

Letra e Rekomandimit: O3-1.FMAN.01.FRM.019b Recommendation

**Recommendation**  
(Part-66 compliant applications only)

1. Engineer's Name: \_\_\_\_\_

2. CAA Reference Number (if known) \_\_\_\_\_

---

I support the above Engineer's application for the following:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

It is hereby certified that the applicant has met the relevant maintenance knowledge and experience requirements of Part-66 and it is recommended that the competent authority grants or endorses the Part 66 compliant AML.

For Category C application only:

I can confirm that the above individual has been exercising Category B1/B2 privileges for 3 years.

Name.....

Signature.....Date.....

Email address.....

Organisations approval number.....